



Bashkimi Evropian
Instrumenti për ndihmën Para- Anëtarësimi
Për Zhvillimin Rural – IPARD II

NJOFTIM PARAPRAK
THIRRJA E PARË PËR APLIKIME Nr. 01/2018
Nga Programi IPARD II

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural e Shqipërisë njofton thirrjen e Parë për dorëzimin e Aplikimeve në kuadër të Programit IPARD II nga Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimi (IPA) për Zhvillimin Rural (IPARD) me qëllim të zhvillimit të Sektorit të Agro Ushqimor.

Thirrja është e hapur për të gjithë personat (persona fizik dhe juridikë), puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor /ose të agro-përpunimit dhe rural me fokus në masat e mëposhtme:

Masa 1: "Investimet në asetet fizike të fermave bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm:

- Qumësht
- Mish
- Fruta
- Perime
- Vresht

Masa 3: "Investimet në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm:

- Qumështi dhe përpunimi i qumështit
- Përpunimi i mishit
- Përpunimi i frutave dhe perimeve
- Vera

Masa 7: "Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit" me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm;

- Prodhimi i bimëve medicinale aromatike, kërpudhave, mjaltit, bimëve dekorative dhe kërmijve;
- Përpunimi dhe tregtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra dhe të kultivuara, kërpudhave dhe mjaltit;
- Përpunimi në nivel ferme dhe tregtimi i prodhimeve bujqësore;
- Akuakultura;
- Turizmi i natyrës dhe ai rural;
- Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale;
- Industria e artizanatit dhe punishtet e prodhimit;
- Prodhimi dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme.

Buxheti i përgjithshëm në dispozicion të kësaj thirrje është 50.33 milion EURO nga të cilat 75% ose 37.74 Milion EURO kontribut i BE dhe 25% ose 12.58 Milion EURO kontribut i buxhetit të shtetit.

Masa 1: me buxhet total 21.65 milion EURO, me një minimum prej 10,000 EURO dhe maksimum 500,000 EURO. Përqindja e mbështetjes është 60% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit, 65% nëse investimi bëhet nga një fermer i ri (nën 40 vjeç), 70% për investimet në zonat malore.

Masa 3: me buxhet total 20.37 milion EURO, me një minimum 25,000 EURO dhe maksimum 2,000,000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 50% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Masa 7: me buxhet total 8.30 milion EURO, me një minimum 10,000 EURO, maksimumi 400,000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 65% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve në udhëzuesin për Aplikantët, i cili mund të kërkohet si një kopje e printuar në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) gjatë orëve të punës 08:00-16:30.

Gjithashtu, Udhëzuesi për Aplikantët mund të shkarkohet nga faqja e internetit: www.azhbr.gov.al dhe <http://www.bujqesia.gov.al>

Thirrja për aplikime do të hapet në datën 30 Nëntor 2018. Afati i fundit i pranimit të aplikimeve është 30 Janar 2019.

Kontaktet:

Tel: 0800 83 83

Email: info@azhbr.gov.al